



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:145174  
Datë: 17.04.2024  
Numri i dokumentit: 05586347

**PAKR.nr.593/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Xhevdet Abazi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.A., nga fshati ....., Komuna e Mitrovicës, për shkak të veprave penale, vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar Sh.D., av.Sabit Rama dhe mbrojtësit së të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.40/2019, të dt.06.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.20.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohen** si të pabazuara ankesat, e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar Sh.D., av.Sabit Rama dhe mbrojtësit së të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.40/2019, të dt.06.09.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.40/2019, të dt.06.09.2023, është shpallur fajtor i akuzuari H.A., për shkak të veprave penale, vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar,

-për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej tri (3) viteve, dhe

-për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

Në kuptim të nenit 80 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KPK, të akuzuarit gjykata i ka shqiptuar dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vite e tre (3) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 26.10.2018, deri më datë 20.12.2018, dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 20.12.2018, deri më datë 20.01.2019, i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 50 (pesëdhjetë) Euro, paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) Euro dhe ne emër të Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari Sh.D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko - civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.40/2019, i dt.06.09.2023, të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ashpër,

- përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar Sh.D., av.Sabit Rama, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, me të cilin në tërësi do të arrihet efekti i sanksionit penal, dhe

- mbrojtësi i të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me dënimin, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari të shpallet i pa fajshëm, ose që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, apo në rastin më të pafavorshëm dënimi të zvogëlohet, ndërsa ankesën e Prokurorisë Themelore – DKR në Mitrovicë, ta refuzoj si të pabazuar.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresat, PPA/I.nr.536/2023, të datës 05.10.2023, dhe PPA/I.nr.536/2023, të dt.18.10.2023, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të aprovohet si e bazuar, ashtu që të ndryshohet vendimi për dënimin, dhe të akuzuarit H.A., ti shqiptohet dënim më i ashpër, ndërsa që të refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri. Sa i përket ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar Sh.D., av.Sabit Rama, e njëjta të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.40/2019, të dt.06.09.2023, të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër me burgim efektiv.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.20.03.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i dëmtuari Sh.D., përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av.Sabit Rama dhe mbrojtësi i të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri.

Nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, i akuzuari H.A., edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar Sh.D., av.Sabit Rama, ka deklaruar se mbetet pranë ankesës së ushtruar me shkrim, duke shtuar se të akuzuarit i është shqiptuar dënim i butë në raport me peshën e veprës penale, andaj kërkon dënim më të ashpër.

I dëmtuari Sh.D., ka deklaruar se e mbështet ankesën e përfaqësuesit të autorizuar, av.Sabit Rama.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, deklaroi se mbetet pranë ankesës së ushtruar me shkrim, dhe se në rastin konkret nuk kemi pasur ekspert përkatës që i vlerëson rrethanat faktike në teren, që kanë ndikuar në mos vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, andaj propozon që i akuzuari të lirohet nga akuza, kurse në rastin më të pafavorshëm, që çështja penale të anulohet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar Sh.D., av.Sabit Rama dhe mbrojtësit së të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

**Ankesat, e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar Sh.D., av.Sabit Rama dhe mbrojtësit së të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, nuk janë të bazuara.**

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës

penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 të KPPK, lidhur me nenin 369 të KPPK. Nga kjo çështje penale rezulton se me aktgjykim, gjykata e shkallës së parë nuk i ka arsyetuar faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet, zbatimi i dispozitës përkatëse, të paraparë në dispozitat ligjore. Sa i përket aktgjykimit të nxjerr në këtë çështje penale, përkundër asaj që është aktgjykim dënues, dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm, kundërthënës me brendinë e tij dhe arsyetimin e dhënë, për të vërtetuar faktet vendimtare, të veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit. Po ashtu gjykata e shkallës së parë, nuk i ka zbatuar obligimet ligjore të parapara në nenin 3,7,8,48,101 dhe 257 të KPPK, që janë obligime të dala edhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6 dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31. Dispozitivi i aktgjykimit është kopje e dispozitivit të aktakuzës, edhe pse referuar dispozitat ligjore nga neni 360 par.1 dhe 2 të KPPK, në mënyrë shprehimore parashihet se aktgjykimi duhet bazuar vetëm në faktet dhe provat të cilat procedohen, kurse kjo nuk rezulton në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Të gjitha provat personale dhe ato materiale, nuk janë vlerësuar në masë të duhur, ashtu që e bëjnë aktgjykimin të pa qëndrueshëm dhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 lidhur me nenin 269 të KPPK.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, sikurse pretendon mbrojtësi i të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk përfshihet me shkelje të parapara në nenin 384 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 të KPPK. Gjithashtu ka vlerësuar aktgjykimin së bashku me të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i të njëjtit është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, si dhe me pjesë të tjera të aktgjykimit, ngase përmban arsytet vendimtare lidhur me faktet të cilat vërtetojnë se në veprimet e akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, ashtu që gjatë zhvillimeve procedurale, ka zbatuar në përpikëri dispozitat përkatëse ligjore, duke u përkujdesur që aktgjykimi mos të përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 lidhur me nenin 369 të KPPK.

Se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë të qartë dhe të drejtë të gjitha dispozitat ligjore, rezulton se gjatë procedimit me provat personale dhe materiale, që të gjitha janë proceduar dhe vlerësuar konformë dispozitës përkatëse ligjore, duke mos u përfshirë në asnjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, përkundër asaj që mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se në këtë çështje penale është shkelur neni 3,7,8,48,101 dhe 257 të KPPK.

Se është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, secila dispozitë ligjore, rezulton nga vlerësimi i aktgjykimit të ankimuar, që janë respektuar parimet sikurse është parimi i prezumimit të pa fajësisë së të akuzuarit, si dhe parimi “indubio pro reo”, që gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarit pasi që janë formuluar elementet qenësore të veprave penale, atëherë ka pasur parasysh se edhe gjatë zhvillimeve procedurale nga ana e secilit organ i cili ka zhvilluar procedurë, siç është policia, prokuroria si dhe gjykata kanë zbatuar profesionalizëm në vlerësimin e të gjitha çështjeve të cilat parashihen në nenin 7, si dhe nenin 8,

duke vepruar si organ i pa varur dhe duke u thirrur edhe në dispozitat ligjore të parapara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 6 dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në nenin 31. Në vijimësi, rezultoi se edhe neni 48, është zbatuar në mënyrë të duhur nga ana e prokurorisë, e cila i ka përmbushur të gjitha detyrat sipas kompetencave të saja, që parashihen në nenin 48 të KPPK, duke i zbatuar të gjitha parimet e përgjithshme gjatë fazës së hetimeve, të paraparë në nenin 101, andaj si rezultat i zbatimit të gjitha parimeve procedurale, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar se në këtë çështje penale është zbatuar edhe dispozita ligjore, nga neni 257 e KPPK. Gjithashtu, duke vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, gjykata e shkallës së parë, drejt ka vlerësuar që gjatë vlerësimit të gjitha provave, me ndërgjegje të plotë, të njëjtit i ka vlerësuar, epo ashtu pasi që i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ka ardhur në përfundim që në këtë çështje penale duhet nxjerrë aktgjykim dënues, sepse vepra penale për të cilat është shpallur fajtor i akuzuari, së bashku me faktet dhe rrethanat përbënë figurën e veprës penale, duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore në përpikëri.

Po ashtu kolegji ka ardhur në përfundim se pasi që janë vlerësuar se në këtë çështje penale janë zbatuar në mënyrë të qartë dhe të drejtë të gjitha dispozitat ligjore, të cilat do të kushtëzonin shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, atëherë rezultoi se përmbajtja dhe forma e aktgjykimit me shkrim, është konform dispozitës përkatëse ligjore, sepse aktgjykimi i përpiluar me shkrim është në përputhje me aktgjykimin e shpallur, duke përmbajtur pjesët kryesore, sikurse është hyrja, dispozitivi dhe arsyetimi, në të cilat pjesë janë paraqitur të gjitha çështjet të cilat e karakterizojnë të njëjtin.

Po ashtu janë zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe dispozita ligjore nga neni 364 e KPPK, dhe se gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në nenin 369 par.6,7 dhe 8 të KPPK, ka dhënë arsye të qarta dhe të plota për çdo pikë të aktgjykimit, duke paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara, ka paraqitur dhe vlerësuar saktësinë e provave, të cilat janë ngritur për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale, andaj edhe me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, janë dhënë arsye të mjaftueshme për secilën çështje të paraparë në aktgjykim.

Po ashtu sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, duke pretenduar se si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, atëherë rezultoi se është shkelur edhe ligji penal, në dëm të mbrojturit të tij, sepse i njëjti është shpallur fajtor për shkak të dy veprave penale sikurse janë paraparë në dispozitiv të aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë, nuk e ka vërtetuar çështjen e kauzalitetit të paraqitjes së këtyre veprave penale dhe se nuk ka vlerësuar të gjitha veprimet të cilit i ka kryer apo jo i akuzuari.

Po ashtu nuk ka vlerësuar se i dëmtuari kishte dhënë deklarata kontradiktore në shqyrtimin kryesor, në raport me ato në procedurën paraprake, të cilat është dashur që të vlerësohen dhe vijnë si rezultat i shkeljeve të ligjit penal.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe ka

ardhur në përfundim se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe të plotë, janë vërtetuar elementet e secilës veprë penale, sikurse janë përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që të njëjtat vepra penale janë të parapara në ligjin e aplikueshëm, duke i vlerësuar dhe paraqitur në mënyrë të qartë dhe të drejtë të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë, pra ka vërtetuar elementet e veprës penale të vrasjes, si dhe mbetjes në tentativë të veprës penale të vrasjes, e po ashtu edhe veprës penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve. Nga aktgjykimi rezulton se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, të parapara në nenin 385 të KPPK, se nuk janë gjetur arsyet të cilat e përjashtojnë të akuzuarin, nga ndjekja penale dhe përgjegjësia penale, se gjykata e shkallës së parë duke vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, ka pasur parasysh të gjitha çështjet e vërtetimit të ekzistimit të veprave penale, si dhe me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, është bazuar në dispozitat përkatëse ligjore.

Po ashtu aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljeve së ligjit penal, edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse me asnjë provë nuk është provua se i akuzuari H.A., ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor. Provat materiale të propozuara sikurse në aktakuzë, rezulton se deklarata e marrë në polici, nuk është përjashtuar nga shkresat e lëndës, e as raporti policor, nga i cili është konstatuar sipas konstatimit të oficerit, sipas raportit 2018-BI-130I, i dt.25.10.2018, në të cilin thuhet se është kontrolluar shtëpia e të dyshuarit H.A., dhe është konstatuar se nuk është gjetur asgjë e dyshuar që mund të lidhet me rastin, se raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, nuk e lidh të akuzuarin me asnjë dëshmi, me të cilën mund të vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale, se raportet mjekësore dëshmojnë për lëndime, por kurrsesi nuk ndërlihet se si dhe me çka janë shkaktuar, se ekspertiza mjeko ligjore, e cila ka mbetur pa u elaboruar apo dhënë sqarime lidhur me te, sepse eksperti nuk është lidhur me pozitën e të dëmtuarit, si dhe formën e lëndimeve të pësura. Gjykata detyrimisht është dashur që të thërret ekspertin mjekoligjor Dr.Flamur Dylhasi, për të sqaruar mendimin përkitazi me lëndimet e të dëmtuarit. Nuk ka vend shiqim as skicë se ku ka ndodhur i akuzuari në kohën e kryerjes së këtij rasti.

Sa i përket pikës II të aktakuzës, nuk është dhënë asnjë përshkrim se cila armë është përdorë nga i akuzuari, por këtë e ka bërë mbi bazën e supozimit së të dëmtuarit, i cili kishte njohuri për armë, duke dhënë arsye të ndryshme lidhur me të njëjtat. Nga bastisja e kryer në shtëpinë e të akuzuarit, nuk është gjetur asgjë, por për qudi nuk është bastisur shtëpia e të dëmtuarit, për të cilën armë i akuzuari ka theksuar se është e të dëmtuarit. Të gjitha provat materiale nga shkresat e lëndës shkojnë në favor të të akuzuarit, por trupi gjykues, nuk i ka vlerësuar dhe pasur parasysh për të vërtetuar ekzistimin apo mos ekzistimin e të njëjtës nga i akuzuari. Nga të gjithë dëshmitarët e dëgjuar, sikurse është deklarata e të dëmtuarit Sh.D., me dt.04.07.2023, ka theksuar se e pranon deklaratën e dhënë me dt.05.12.2018, të cilën e ka pranuar si deklaratë të veten dhe të dhënë në prezencën e mbrojtësit të vet të autorizuarit, e po ashtu nga deklarata e dhënë në prokurori, rezulton se nuk vërtetohet në mënyrë të qartë se si e ka goditur këtu i akuzuari, duke theksuar se ai djali më ka goditur me “cevë” në kryer, ndërsa në shqyrtimin kryesor thekson se Hyseni, më ka goditur me

“cevë” në krye, ashtu që nuk është i qartë me përshkrimin e ndodhur që ndërlidhen me veprimet e ndërmarra nga ana e këtu të akuzuarit.

Po ashtu edhe deklaratat e dëshmitarëve Sh.D.B., motra e të dëmtuarit Sh.D., kryesisht deklaratën e mbështet në deklaratimet e të dëmtuarit, sikurse është edhe deklarata e I.T., përndryshe shoku i të dëmtuarit Sh.D., ka mos përputhje të deklaratës së dhënë në polici dhe shqyrtim kryesor, të cilat gjykata e shkallës së parë nuk i ka eliminuar. Dëshmitari i prokurorisë L.M., në pyetjen e drejtpërdrejt është deklaruar se nuk i ka parë të gjitha këto, por vetëm i thotë me të dëgjuar sikurse dëshmitari S.S., andaj që të gjitha këto deklarata kanë mos përputhje në mes veti. Në këtë çështje penale edhe i akuzuari nuk e ka pranuar se ka kryer këtë veprë penale, për çka ka propozuar që të lirohet nga akuza.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të të gjitha deklaratave personale, si dhe vlerësimit të provave materiale nga shkresat e lëndës, ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale të vrasjes në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, duke bërë përshkrimin në mënyrë të detajuar të gjendjes faktike, nga e cila rezulton e me dt.25.10.2018, në intervalin kohor nga ora 20-20:30minuta në fshatin ....., Komuna e Mitrovicës, saktësisht në rrugën “.....”, me dashje ka filluar kryerjen e veprës penale të vrasjes në drejtim të dëmtuarit Sh.D., duke mos e përfunduar, ashtu që vepra penale e vrasjes e ngelur në tentativë është përshkruar në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke u materializuar me nxjerrjen e armës – revoles, nga ana e të akuzuarit, duke shtënë tri herë në drejtim të dëmtuarit, nga të cilat të shtëna, dy herë e ka goditur, njëherë në dorën e majtë dhe njëherë në këmbën e majtë, më pastaj i dëmtuari është ngritur dhe ka ikur, duke shkuar në shtëpi, andaj të gjitha këto lëndime janë të karakterit të rëndë. Kjo gjendje faktike, vërteton se në veprimet e të akuzuarit, janë kryer elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë, si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve, për të cilat është shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Gjykata e shkallës së parë, ka administruar të gjitha provat personale sikurse janë deklaratat e këtu të akuzuarit H.A., e të dëmtuarit Sh.D.t, e dëshmitarëve Sh.D.1., I.T., S.S. dhe L.M., të gjitha provat materiale sikurse janë raporti i policisë, deklarata e të dëmtuarit në polici, raporti për mbikëqyrjen e vendit të ngjarjes, zinxhiri i ruajtjes së dëshmive, raporti mjekësor si dhe fletë lëshimet e QKUK-së, klinika e Ortopedisë dhe Truamtologjisë Lokomotore në Prishtinë, me numër të historisë 21362, të dt.14.11.2018, foto dokumentacioni nga shkresat e lënës, ekspertiza mjeko -ligjore me nr. të referencës 0101/2019-0244-2019221, e dt.22.09.2019, e kryer nga IML-eksperti Dr.Flamur Dylhasi, e që të gjitha këto prova sikurse personale po ashtu edhe materiale në mënyrë të pa dyshimtë vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

Përkundër asaj që i akuzuari është munduar që ti shmanget përgjegjësisë penale - juridike për veprat penale të kryera nga ana e të gjitha dëshmive të tjera sikurse personale, po ashtu edhe materiale në mënyrë të pa dyshimtë është vërtetuar se ditën kritike i akuzuari ka kryer veprat penale, për të cilat është akuzuar, dhe janë vërtetuar në mënyrë të qartë të gjitha faktet pasi që janë administruar të gjitha provat nga shkresat e lëndës. Po ashtu gjykata në mbështetje të dispozitave

ligjore të KPPK, pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe pas vlerësimit të të njëjtëve, pasi që ka pasur dëshmi të bollshme në këtë çështje penale, sikurse është deklarata e të dëmtuarit Sh.D., dëshmitarëve, Sh.D.B. I.T., S.S., L.M., si dhe të gjitha provat materiale në mënyrë të qartë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, janë formuluar elementet qenësore të vrasjes në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK.

Edhe për shkak të vendimit për dënimin e shqiptuar ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit, duke pretenduar se dënimi i shqiptuar nuk është i bazuar, sepse i akuzuari nuk ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, andaj gjykata është dashur që ta liroj prej dënimit.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë e ka shpallur fajtor të njëjtin për dy vepra penale të përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, mirëpo i ka shqiptuar dënim të butë dhe ka ra ndesh me dispozitat përkatëse ligjore, kur ka bërë zbutjen e dënimit në kuptim të nenit 76 par.1 pika 1.2 të KPK, duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese se i akuzuari është i martuar, baba i shtatë fëmijëve, mbajtës i familjes, ndërsa si rrethanë rënduese gjeti shkallën e intensitetit të veprave të kryera penale, se i dëmtuari Sh.D., është goditur dy herë nga i akuzuari me armë zjarri, i cili ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme për shëndetin. Po ashtu ka pasur parasysh edhe mënyrën e kryerjes së veprave penale, andaj ka propozuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër.

Në këtë çështje penale ankesë ka ushtruar edhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar Sh.D., av.Sabit Rama, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se në këtë çështje penale të akuzuarit i është shqiptuar dënim i butë në krahasim me veprat penale të kryera, sepse kemi të bëjmë me vepër penale të vrasjes në tentativë, dhe veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, andaj me dënimet e shqiptuara nuk mund të pritët që të arrihet efekti dhe qëllimi i tij ngase të njëjtat janë të buta, dhe propozon dënim më të ashpër me burgim.

Kolegji i kësaj gjykata ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me ankesat e ushtruara, nga ana e prokurorisë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar Sh.D., av.Sabit Rama, si dhe nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, si dhe gjendja faktike, është vërtetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë, me vlerësimin e të gjitha provave, sikurse janë ato materiale dhe ato personale.

Kolegji ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale në mënyrë të qartë janë zbatuar dispozitat, nga neni 73 lidhur me nenin 74 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari është i martuar, baba i shtatë fëmijëve, mbajtës i familjes, ndërsa si rrethanë rënduese ka pasur parasysh shkallën e intensitetit të kryerjes së veprës penale, si dhe mënyrën e kryerjes së të njëjtës, ngase në rastin konkret i dëmtuari është goditur dy herë me armë të zjarrtë nga i akuzuari dhe si



rezultat i të njëjtave goditje ka pësuar dëmtime të përhershme për shëndetin e tij. Po ashtu pasi që ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, si dhe veprës penale të armëmbajtjes pa leje, ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimeve, nga neni 75 par.1 pika 1.1 dhe lidhur me nenin 76 par.1 pika 1.2 të KPK, e cila zbutje është e lejueshme brenda kufijve ligjor, që të akuzuarit mund ti shqiptohet dënim me burgim, minimum tri vite, ashtu që ka pasur parasysh edhe dispozitën ligjore, nga neni 80 të KPPK, për shqiptimin e dënimit unik, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 3 (tre) muaj.

Nga ankesa e prokurorisë, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, sikurse që nuk ka gjetur as nga ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar Sh.D., av.Sabit Rama, e as nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit H.A., av.Vehbi Beqiri, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.593/2023, të datës 20.03.2024**

**Bashkëpunëtori profesional,**  
**Endrit Ajeti**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Kadrije Goga Lubishtani**

**Xhevdet Abazi**